

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 338, Datë 23.12.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR
PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN,
RINOVIMIN DHE HEQJEN E LICENSAVE NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 109, DATË
29.06.2016, E NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 22 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1416/6 prot., datë 22.12.2025, të Grupit të Punës “Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Me Vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, bordi i ERE-s në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”. të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 215, datë 20.12.2019 dhe me vendimin nr. 220, datë 01.09.2022.
- Ndryshimet e mëparshme në këtë rregullore kanë pasur për qëllim përafrimin me ndryshimet ligjore, rikonceptimin e të dhënave identifikuese dhe teknike të subjekteve, si dhe përgatitjen e formularëve standardë të aplikimit, në formën e shtojcave, si pjesë integrale e rregullores.
- Në nenin 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është përcaktuar se ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin,

transferimin ose heqjen e licencave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

- Nga shqyrtimi dhe analizimi i aplikimeve të paraqitura pranë ERE-s, sipas llojit të licencës, është evidentuar nevoja për përmirësimin dhe saktësimin e mëtejshëm të dokumentacionit, afateve dhe procedurave përkatëse.
- Ndryshimet e propozuara në *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, synojnë rritjen e qartësisë, unifikimin e praktikave administrative dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së rregullores, si dhe reflektimin përkatës në shtojcat udhëzuese, sipas llojit të aplikimit.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar. (Drafti i ndryshimeve të propozuara bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Grupi i Punës, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrir AHMETI

DRAFT-NDRYSHIMET
E PROPOZUARA NË “RREGULLOREN PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR
DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN, RINOVIMIN, NJOHJEN DHE HEQJEN
E LICENCEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE NR. 109, DATË 29.06.2016, E NDRYSHUAR

- **Në Nenin 4, “Licencat”, propozohen ndryshimet si vijon:**
 - **pika 4**, ndryshon si vijon:
 4. *Për atë që ka lejon legjislativ në fuqi i Republikës së Shqipërisë, nuk do të kërkohet aplikimi për licencim për tregtimin e energjisë elektrike ose furnizimin me energji elektrike në rast se një shoqëri ka një licencë të lëshuar nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë/një shteti Anëtar të Bashkimit Evropian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licenceve ndërmjet ERE-s dhe autoritetit përkatës rregullator, duke u bazuar në parimin e reciprocitetit, si dhe me kusht që ato të dorëzojnë në ERE licencën e përkthyer dhe noterizuar si dhe sa përcaktuar në nenin 9 pika 1.1 dhe 1.2, përkatësisht të këtyre rregullave.*
- **Në nenin 7, Delegimi i të Drejtave të Aplikuesit, propozohen ndryshimet si vijon:**
 - **pika 3**, ndryshon si vijon:
 3. *Detyrat e përfaqësuesit janë:*
- **Në nenin 8, Paraqitja e aplikimit, propozohen ndryshimet si vijon:**
 - **pika 3**, ndryshon si vijon:
 3. *Dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose fotokopje e noterizuar/njëzuar me origjinalin. Një kopje e këtij dokumentacioni duhet të depozitohet në format elektronik (në CD, USB ose e-mail në adresën zyrtare të ERE-s) ku secili dokument duhet të jetë skanuar më vete dhe i emërtuar saktë. Vërtetimet dhe deklaratat nga organet e tjera duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.*
 - **pika 4**, ndryshon si vijon:
 4. *Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion, dokumentin e aplikimit dhe/ose korrespondencën përkatëse me organin/institucionin kompetent për lëshimin e këtyre lejeve.*
- **Në nenin 9, Formatet dhe dokumentacioni për aplikim, pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për licencë, propozohen ndryshimet si vijon:**
 - **pika 1.2, përkatësisht b),** ndryshon si vijon:
 - b) *Vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë, administratorin/ administratorët e saj, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në rastet kur administratori i shoqërisë nuk ka rezidencë në Republikën e Shqipërisë, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të rezidencës, i përkthyer në shqip dhe i pajisur me vulë apostile.*

- **pika 1.2, germa c),** ndryshon si vijon:
 - c) *strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik efektiv (staf administrativ, ligjor apo inxhinierik, dhe/ose mbështetës) sipas veprimtarisë për të cilën paraqitet aplikimi.*
- **pika 1.3, germa b),** ndryshon si vijon:
 - b) *Dokumente që vërtetojnë se aplikuesi ka siguruar mjetet financiare për ushtrimin e veprimtarisë financim i vetë aplikuesit ose ortakëve/aksionerëve të tij, i shprehur nëpërmjet një vendimi të organeve drejtuese, letër interesi për financim nga banka, marrëveshje kredie bankare, marrëveshje huaje, donacion, etj.) për ushtrimin e veprimtarisë. Në rastin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike duhet të dokumentohet mbështetja financiare për realizimin e plotë të vlerës së investimit, sikurse miratuar nga institucionet përkatëse. Në rast se impianti/centrali për prodhimin e energjisë elektrike është i ndërtuar në momentin e paraqitjes së aplikimit, duhet të paraqitet informacioni përkatës mbi mënyrën se si është financuar ndërtimi i tij. Në rastin e veprimtarisë së tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike, mbështetja financiare duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi dhe përlllogaritjes që do të bëhet duke marrë për bazë çmimin mujor të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX, që i korrespondon muajit që i paraprin datës së aplikimit).*
- **Në nenin 9, Formati dhe dokumentacioni për aplikim, pika 2, “Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor”, propozohen ndryshimet si vijon:**
 - **pika 2.1, germa b),** ndryshon si vijon:
 - b) *marrëveshjen e koncesionit/autorizimin, apo çdo formë tjetër të marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi. Gjithashtu, aplikuesi duhet të depozitojë dhe informacionin/dokumentacionin përkatës në lidhje me zbatimin e afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje/autorizim për ndërtimin dhe vënien në operim të burimit gjenerues të energjisë elektrike (si p.sh., raportimet periodike)*
 - **pika 2.1, germa d),** ndryshon si vijon:
 - d) *lejen e përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet/TEC-et.*
 - **pika 2.1, germa e),** ndryshon si vijon:
 - e) *miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje). Në rastet kur vlefshmëria e këtyre dokumenteve kushtëzohet me fillimin e punimeve, duhet të depozitohet informacioni/dokumentacioni përkatës në lidhje me fillimin e tyre (proces-verbal, njoftim drejtuar organeve/institucioneve përgjegjëse etj.).*
 - **pas germës f), shtohet germa g) me këtë përmbajtje:**
 - g) *Në rastin e aplikimeve për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga dielli apo era (fotovoltaike apo eolike), duhet të depozitohet një dokument teknik që vërteton jetëgjatësinë e centralit (si p.sh. garancia e produktit).*

- Në nenin 9, *Formati dhe dokumentacioni për aplikim pika 2.4, Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike*, propozohen ndryshimet si vijon:
 - germa “b”, shfuqizohet.
 - germa “c”, ndryshon si vijon:
 - c) *dokumentacion (dokumentacion pronësor, kontratë qiraje/huapërdorje etj.) mbi disponimin e zyrave përfaqësuese të furnizuesit për të gjithë kohëzgjatjen 5-vjeçare të licencës.*
- Në nenin 10, *“Shqyrtimi i aplikimit” germa “c”*, propozohen ndryshimet si vijon:
 - **pika 1** ndryshon dhe bëhet:
 1. *Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të dhe duke kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të kësaj Rregulloreje. Në rast se nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se dokumentacioni nuk plotëson kërkesat formale apo nuk është kryer pagesa e aplikimit, drejtoria përgjegjëse, brenda 3 (tri) ditëve nga paraqitja e aplikimit, në adresën elektronike të bërë me dije nga shoqëria në formularin e aplikimit apo të konstatuar në dosje, i komunikon asaj sa evidentuar. Shoqëria duhet të bëjë plotësimet përkatëse brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e e-mailit. Pas kalimit të këtij afati dhe pasi shqyrtojnë aplikimin e paraqitur, lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 8, 9, 15,16 dhe 17, personat e ngarkuar nga Drejtoria Përgjegjëse përgatisin një relacion ku i propozojnë Bordit të ERE-s fillimin ose jo të procedurës për shqyrtimin e aplikimit në përputhje me afatet përcaktuara në Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s dhe në këtë rregullore.*
 - **pika 2** ndryshon dhe bëhet:
 2. *Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të dhe duke kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të kësaj Rregulloreje. Në të kundërt, Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurës për shqyrtimin e aplikimit.*
 - **pika 8** ndryshon dhe bëhet:
 8. *Në rast të miratimit të fillimit të procedurës për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit, ERE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në median e shkruar për dy ditë me rradhë një njoftim për aplikimin e paraqitur në dy gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë.*
 - **pika 9** ndryshon dhe bëhet:
 9. *Njoftimi përmban:*
 - a. *një informacion të shkurtër për aplikimin e paraqitur, ku njoftimet për licencim që lidhen me veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike do të përmbajnë shkurtimisht dhe të dhënat lidhur me kapacitet e instaluar, vendndodhjen dhe territorin ku do të kryhet veprimtaria e licencuar;*
 - b. *një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhet në ERE brenda afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.*

- **pika 10** ndryshon dhe bëhet:
 10. *ERE do të presë kundërshtimet e mundshme për këtë aplikim, për një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke nisur nga e nesërmja e ditë së dytë të publikimit të njoftimit për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura me rrjetin e transmetimit. Në paraqitjen e objeksioneve përkatëse, palët e interesuara duhet t'i referohen përcaktimeve të nenit 20 të kësaj Rregulloreje.*
- **Në nenin 11, Plotësimi dhe paraqitja e informacionit shtesë,** propozohen ndryshimet si vijon:
 - **pika 1** ndryshon dhe bëhet:
 1. *ERE mund t'i kërkojë aplikuesit të paraqesë informacion shtesë, në formën dhe përmbajtjen e caktuar brenda një afati të caktuar, lidhur me çdo çështje që ERE e konsideron të nevojshme. Kjo korrespondencë do të zhvillohet brenda afateve të përcaktuara për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për aplikimin e paraqitur.*
- **Në nenin 13, Pranimi ose Refuzimi për Licencim i Aplikuesit,** propozohen ndryshimet si vijon:
 - **pika 2, germa j)** shfuqizohet.
- **Në nenin 14, Pranimi ose Refuzimi për Licencim i Aplikuesit,** propozohen ndryshimet si vijon:
 - **pika 1,** ndryshon dhe bëhet:
 1. *Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike brenda 60 ditëve pune nga e nesërmja e ditës së dytë të publikimit në shtyp të njoftimit për aplikimin për licencë, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.*
 - **pika 2,** ndryshon dhe bëhet:
 2. *Për centralet e lidhur drejtpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes dhe për të gjitha licencat e tjera, Bordi merr vendim jo me vonë se 30 ditë pune nga e nesërmja e ditës së dytë të publikimit në shtyp për aplikimin për licencë, duke e bazuar atë në kriteret e specifikuara në nenin 13 të kësaj rregulloreje.*
 - **pika 6,** ndryshon dhe bëhet:
 6. *Vendimi i ERE-s i dhënë sipas kësaj rregulloreje publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.*
 - **pika 7,** ndryshon dhe bëhet:
 7. *Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.*
 - **pika 8,** ndryshon dhe bëhet:
 8. *Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës, ai mund të bëjë kërkesë në ERE për lëshimin e kopjes së njëzuar të saj. Po ashtu, në rast se i*

licencuari ndryshon emrin e tij, ai mund të bëjë kërkesë për lëshimin e licencës me emrin e ri. Të dyja këto kërkesa bëhen kundrejt një pagese, siç përcaktuar në Aneksin A të kësaj Rregulloreje. Të licencuarit do t'i lëshohet kopja e njësuar e licencës apo licenca me emrin e ri, sipas rastit, vetëm pasi të vërtetohet se ai ka kryer pagesën përkatëse.

- **pika 10**, ndryshon dhe bëhet:

10. Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij. Në rast se pezullimi zgjat më shumë se 3 (muaj), shoqëria duhet të depozitojë vërtetime dhe deklarata të përditësuara.

- **Në nenin 15, Modifikimi i licencës**, propozohen ndryshimet si vijon:

- **pika 4, germa a)** ndryshon dhe bëhet:

a) formatin e plotësuar të aplikimit sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2.

- **pika 4, germa f)** ndryshon dhe bëhet:

f) miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore, në rastet e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet/TEC-et.

- **pas pikës 4, shtohet pika 5**, me përmbajtje, si vijon:

5. Për këtë procedurë do të aplikohen afatet e parashikuara në Nenin 14, pika 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje.

- **Në nenin 16, Rinovimi i licencës**, propozohen ndryshimet si vijon:

- **pika 1, germa b)** ndryshon dhe bëhet:

b) të gjithë dokumentacionin sikurse përcaktuar në Nenin 9 të kësaj rregulloreje, sipas llojit të licencës.

- **në pikën 1, pas germës c), shtohet germa d)** me këtë përmbajtje:

d) Aplikuesi duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit për rinovim dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- **pika 7 shfuqizohet.**

- **Në nenin 17, Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës**, propozohen ndryshimet si vijon:

- **pika 7** ndryshon dhe bëhet:

7. ERE merr vendim për pranimin ose jo të aplikimit brenda 45 ditë pune nga fillimi i procedurave për shqyrtimin e një aplikimi dhe gjatë kësaj periudhe i licencuari do të vazhdojë kryerjen e shërbimit në përputhje me kuadrin ligjor.

- **Në nenin 19, Forma e regjistrimit**, propozohen ndryshimet si vijon:

- **pika 3** ndryshon dhe bëhet:

3. Të dhënat përkatëse në lidhje me licencat për kryerjen e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe tërheqjen e tyre regjistrohen në Regjistrin manual që mbahet nga sekretaria e Bordit.

- **pika 4** ndryshon dhe bëhet:

4. *Regjistri i licencimeve mbahet nga struktura përgjegjëse për licencimet në ERE, dhe përditësohet pas çdo mbledhjeje të Bordit dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky regjistër përmban këto të dhëna:*
- Emrin e të licencuarit;*
 - NUIS-in;*
 - Numrin dhe serinë e licencës;*
 - Numrin dhe datën e vendimit të Bordit të ERE-s;*
 - Kohëzgjatja e licencës;*
 - Vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë elektrike;*
 - Vendimet e licencimit të dhëna me kusht.*
- *Titulli i nenit 20, ndryshohen dhe bëhet E drejta për t'u informuar.*
 - **Në Aneksin A të Rregullores**, shënimi i parë ndryshon dhe bëhet:
 - *Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, duhet të ketë kryer pagesën sipas përcaktimeve të këtij Aneksi. PAGESA e aplikimit është e pakthyeshme dhe mund të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë bankare me të dhënat si vijon, ose pas lëshimit të një fature elektronike nga struktura e financës në ERE, sipas kërkesës së vetë aplikuesit.*
 - **Në Shtojcën 2**, shtohen pikat 7 dhe 8, si vijon:
 - Vendndodhja e saktë e impiantit gjenerues të energjisë elektrike*
 - Mënyra e disponimit të pronës ku ndodhet apo parashikohet të ndërtohet centralit (në pronësi, me qira, me huapërdorje etj.)*
 - *Deklaroj se dokumentacioni i aplikimit i depozituar nga ana ime dhe projekti për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike plotëson të gjitha kërkesat ligjore për:*
 - funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshme të impianteve të pajisjeve dhe/ose të rrjetit;*
 - kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e qytetarëve, pasurinë, shëndetin dhe rendin publik;*
 - mbrojtjen e mjedisit;*
 - nxitjen e eficiencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike;*
 - efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.*